



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN
CIVIL PËR KATEGORINË EKZEKUTIVE (SPECIALIST)**

*Lloji i diplomës “Shkenca Juridike”
niveli minimal i diplomës “Master Profesional ”*

Në zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar , si dhe kreut II, III, IV dhe V të Vendimit nr.243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, peridhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” , Bashkia Skrapar shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive , për pozicionin :

- ***1(një) Specialist i Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, kategoria e pagës IV A***

* Pozicioni i lartë përmendur iu ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

Vetëm në rast se për këtë pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezulton se vendi është përsëri vakant, pozicioni është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

***Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil)
aplikohet në të njëjtën kohë!***

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJEN PARALELE DO TË JETË	01.11.2022
DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL DO TË JETË	08.11.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

PËRSHKRIMI I PUNËS

- Zbaton procedurat ligjore të rekrutimit, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, duke ndjekur dhe asistuar në të gjitha procedurat duke filluar që nga shpallja e vendit të lirë të punës sipas dispozitave ligjore, vlerësimi paraprak i dokumentacionit, shpallja e kandidatëve të kualifikuar për fazën e dytë, shqyrtimi i ankesave, ngritja e komisionit të vlerësimit, hartimi i pyetjeve në intervistën e strukturuar me gojë apo testimin me shkrim sipas udhëzimeve të DAP, shpallja e fituesve deri në emërimin e tyre.

- Merr pjesë në konstatimin e pezullimit nga shërbimi civil, duke filluar nga shqyrtimi nëse janë kushtet ligjore të përcaktuara për pezullimin, ndjekja e afateve dhe efekteve të pezullimit.

-Ndjekja dhe zbatimi i procedurave të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për punonjësit që trajtohen me dispozitat e Kodit të Punës.

-Bashkëpunon me drejtorin e drejtorisë për ndjekjen e trajnimeve të detyrueshme në përfundim të periudhës së provës në ASPA apo të vazhdueshme të nëpunësve civilë.

- Kryerja e detyrave të tjera të ngarkuara nga eprori direkt rast pas rasti, siç janë:

- a) Asistencë ligjore në çështje të ndryshme të drejtorisë.
- b) Plotësimi i dosjeve të personelit sipas kërkesave ligjore dhe azhornimi i tyre.
- c) Përgatitja e shkresave për sektorët, drejtoritë, institucionet e varësisë dhe institucionet e tjera shtetërore.

-Plotëson librezat e punës, regjistron të dhënat e çdo nëpunësi dhe kryen azhornimin e tyre në regjistrin themeltar apo elektronik, etj.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori, (sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar) (kategorisë ekzekutive),
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë një vlerësim pozitiv të paktën mirë apo shumë mirë (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotëroj Diplome Universitare (Arsimi i Lartë) / **Master profesional** sipas legjislacionit të arsimit të lartë ,në shkenca Ekonomike Si diploma Bachelor edhe ajo master profesional duhet të jenë në të njejtën fushë .. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se **një vit**, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e Qeverisjes Vendore
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Njohja e gjuhës se huaj Anglisht ose ndonjë gjuhë tjetër të BE-së

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose dorazi pranë Drejtorisë Burimeve Njerëzore të Bashkisë Skrapar , brenda datës **01.11.2022**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
- e- Certifikate Personale
- f- Certifikate familjare
- g- Aktin e statusit të nëpunësit Civil
- h- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- i- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore/ Dëshmi i gjëndjes gjyqësore (Dëshmi Penale)
- j- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- k- Certifikata e njohjes se gjuhës së huaj
- l- Vërtetim nga Institucioni qe nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- m-** Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **02.11.2022**, Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Skrapar do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, faqjen zyrtare të bashkisë dhe stendat e informimit të Publikut ,listën e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë .

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si edhe Aktet nën ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil
- Njohuritë mbi ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e konfliktit të interesave”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi ligjin 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative
- Njohuritë mbi ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”
- Njohuritë mbi ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen me pikë sipas skemës së vlerësimit si më poshtë:

- **40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar** (20 pikë - përvoja 10 pikë – trajnimet ose kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse ; 10 pikë - vlerësimet e rezultateve individuale në punë).
- **60 pikë intervista e strukturuar me gojë.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm .

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Skrapar do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, faqjen zyrtare të bashkisë dhe stendat e informimit të Publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike .

2- Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21,22 të Ligjit nr. 152/2013:

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotëroj Diplome Universitare (Arsimi i Lartë) / **Master Profesional** sipas legjislacionit të arsimit të lartë ,në shkenca Ekonomike si , Finance-Kontabilitet..Juridike,Shoqërore etj.. Si diploma Bachelor edhe ajo master profesional duhet të jenë në të njejtën fushë .. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Eksperienca në punë, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e Qeverisjes Vendore përbën avantazh.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe
- d) Njohja e gjuhes se huaj Anglisht ose ndonjë gjuhe tjetër të BE-së

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Certifikate Familjare
- f- Certifikate Personale
- g- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- h- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore/ Dëshmi i gjendjes gjyqësore (Deshmi Penale)
- i- Certifikata e gjuhes se huaj .
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose dorazi pranë Drejtorisë Burimeve Njerëzore të Bashkisë Skrapar, brenda datës **08.11.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **10.11.2022** Njësia Pergjegjëse e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Skrapar do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, faqjen zyrtare të bashkisë dhe standat e informimit të Publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta dhe kushtet e pranimit në shërbimin civil , si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për pranimin në shërbimin civil do të njoftohen individualisht nga Njësia Pergjegjëse e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Skrapar , nëpërmjet email- it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si edhe Aktet nën ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil
- Njohuritë mbi ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi ligjin 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative
- Njohuritë mbi ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”
- Njohuritë mbi ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen me pikë sipas skemës së vlerësimit si më poshtë:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike (DAP)

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm .

2.6

**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE
MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Skrapar do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, faqjen zyrtare të bashkisë dhe stendat e informimit të Publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike .